



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 500/0 prot.,

Datë 20.05 2024

RAPORT

PËR

**KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË  
PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS ME OBJEKT:  
“DOKUMENTIMI NGA GJYQTARËT I INFORMIMIT TË PALËVE RRETH  
MUNDËSISË PËR ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES ME NDËRMJETËSIM PËR  
PERIUDHËN 01.06.2023 – 31.12.2023”, TË INSPEKTORIT TË LARTË TË  
DREJTËSISË**

Në zbatim të vendimit nr. 7, datë 15.02.2024, “Për kryerjen e inspektimit tematik të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me objekt: “Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.06.2023 – 31.12.2023”

Tiranë, më 20.05.2024

## INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

### Titulli:

Raporti i Inspektimit Tematik të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me objekt: “Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.06.2023 – 31.12.2023”,

### Data e përgatitjes:

20.05.2024

### Përgatitur nga:

Znj. Erjena Bashari  
Z. Periand Teta





### Për shqyrtim nga:

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë**

Z. Artur Metani

Miratoi  Ktheu  Ndryshoi

Datë: 20.05.2024



So 08

Edward  
J.

So 08  
Edward  
J.

## I. Pjesa hyrëse

Në mbështetje të nenit 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Kontratës Sektoriale "BE për Reformën në Drejtësi", miratuar me vendimin nr. 476, datë 10.07.2019, të Këshillit të Ministrave mbi "Miratimin në parim të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2018, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA II)", Inspektori i Lartë i Drejtësisë (këtu e në vijim ILD) kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të detyrave të tij të përcaktuara në nenin 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 194, pika 4 dhe nenit 204, pika 1, shkronjat "dh", "ë" dhe "k" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka miratuar me vendimin nr. 5, datë 31.01.2024 "*Planin e inspektimeve për vitin 2024*".

Në këtë kuadër, nisur nga ushtrimi i kompetencave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përsa i përket kontrollit të veprimtarisë së magjistratëve dhe bazuar në vendimin nr. 5, datë 31.01.2024 "*Planin e inspektimeve për vitin 2024*", është planifikuar zhvillimi i një inspektimi tematik në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me objekt "*Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjeve me ndërmjetësim për periudhën 01.10.2023 – 31.12.2023*".

Për kryerjen e inspektimit, sipas vendimit nr. 7, datë 15.02.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndryshuar në vijimësi me vendimin nr. 7/1, datë 29.03.2024, u angazhuan inspektorët Erjena Bashari dhe Periand Teta. Me qëllim rritjen e efikasitetit të grupit të inspektimit dhe miradministrimit të procesit, me të njëjtin vendim është caktuar si kryetar grupi inspektori znj. Erjena Bashari.

Arsyeja e inicimit të këtij inspektimi konsiston në njohjen e praktikës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës gjatë periudhës 01.10.2023 – 31.12.2023 si dhe aktet që ka lëshuar gjykata për aplikimin e ndërmjetësimit në trajtimin e konflikteve, me qëllim arritjen e një zgjidhjeje të kënaqshme për palët e përfshira në konflikt; transparencën që ka ndjekur dhe ndjek gjykata në dokumentimin e informimit të palëve nga gjyqtarët lidhur me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim në proceset civile; mënyrën e zbatimit të ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjes", i ndryshuar, dispozitave të K. Pr. Civile, të cilat vendosin gjykatën në një rol aktiv me qëllim nxitjen e zbatimit të procedurës së ndërmjetësimit.

Burimet e së drejtës, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së veprimtarisë së gjyqtarëve lidhur me objektin e inspektimit janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 10385/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar.

Kryerja e inspektimit është planifikuar sipas vendimit të inspektimit, për realizimin e tij sipas këtyre fazave:

1. Faza e parë: *“Përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akte, si dhe zhvillimin e verifikimeve apo vizitave pranë gjykatave”*. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
  - a) Është hartuar plani i punës, i dakordësuar nga inspektorët, në datë 19.02.2024;
  - b) Janë hartuar shkresat drejtuar gjykatës objekt inspektimi, sipas një modeli të dakordësuar nga inspektorët, të cilat janë nisur në datën 20.02.2024;
  - c) Është administruar dokumentacioni dhe informacioni nga gjykata dhe përpunimi paraprak i tyre.
2. Faza e dytë: *“Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur”*. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
  - a) Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur dhe studimi i tyre;
  - b) Vlerësimin nëse duhet të merren të dhëna të tjera, informacioni dhe dokumentacion plotësues, të vlerësuar nga grupi i inspektorëve, nëpërmjet dërgimit të shkresës, komunikimit me anë të telefonit dhe vizitës në terren.
3. Faza e tretë: *“Hartimi i Raportit të Inspektimit”*, që ka të përfshirë:
  - a) Hartimi i projekt raportit përfundimtar, i cili do të dërgohet për shqyrtim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pas shqyrtimit dhe daljes së Raportit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do të kalohet në fazën e fundit:

4. Faza e katërt: *“Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të inspektimit brenda 6 muajve nga data e miratimit të raportit përfundimtar të inspektimit dhe rezultateve të inspektimit”*.

Gjatë periudhës së zhvillimit të inspektimit janë konstatuar në mënyrë të përmbledhur problematika të lidhura me paraqitjen me vonesë të informacionit dhe të dhënave të kërkuara në funksion të realizimit të këtij inspektimi nisur dhe nga ngarkesa e vazhdueshme në punë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.



Në informacionin e përcjellë në adresën elektronike [info@ild.al](mailto:info@ild.al) në datë 18.03.2024 regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 500/3 prot. datë 18.03.2024, kancelari i gjykatës në përgjigje të shkresës nr. 500/2 prot., datë 20.02.2024 të ILD-së, ka kërkuar shtyrjen e afatit të vënies në dispozicion të informacionit dhe të dhënave të përpunuara. Për këtë arsye Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 7/1, datë 29.03.2024 vendosi shtyrjen e afatit të inspektimit deri më datë 20.05.2024.

- Inspektimi tematik përfshiu veprimtarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për periudhën 01.10.2023 deri më 31.12.2023.
- Fokusi i inspektimit tematik u përqendrua kryesisht në:
  - (i) Numrin e çështjeve civile themeli të përfunduara për periudhën kohore 01.10.2023-31.12.2023;
  - (ii) Numrin e çështjeve në të cilat gjykata ka informuar palët në lidhje me mundësinë e zgjidhjes së konfliktit me ndërmjetësim;
  - (iii) Numrin e çështjeve në të cilat palët kanë pranuar për ta zgjidhur çështjen me ndërmjetësim.

*Qëllimi* i këtij inspektimi është njohja e praktikës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe vlerësimi nëse gjyqtarët i informojnë vazhdimisht palët për mundësinë për të zgjidhur çështjet përmes ndërmjetësimit; Vlerësimin në aspektin sasior të çështjeve në të cilat palët kanë vendosur të provojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përmes ndërmjetësimit gjatë kësaj periudhe; Vlerësimin në lidhje me llojin e objektit të çështjeve, në të cilat gjykata në ushtrim të kompetencave, edhe në këndvështrim të përputhjes apo harmonizimit të tyre me nenin 25, nenin 158/ç dhe nenin 297/dh të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, ka kryer informimin e palëve në proces; Monitorimin e procesit të ndërmjetësimit dhe efektivitetin e tij.

Inspektimi i zhvilluar mbi veprimtarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës mundësoi njohjen dhe krijimin e një tabloje të përgjithshme mbi aplikimin e procedurës së ndërmjetësimit nga kjo gjykatë nëpërmjet dokumentimit të informimit të palëve në proceset civile për periudhën objekt inspektimi.

Nga të dhënat e administruara gjatë inspektimit për periudhën 01.10.2023 deri më 31.12.2023 dhe nga informacioni i përcjellë rezultoi se:



- Në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës numri i çështjeve civile themeli të përfunduara për periudhën kohore 01.10.2023-31.12.2023 në total është **548 çështje**. Nga këto çështje të përfunduara, vetëm në **62 çështje** gjykata ka informuar palët në lidhje me mundësinë e zgjidhjes së konfliktit me ndërmjetësim. Ndërsa, vetëm në **3 çështje**, palët kanë pranuar për ta zgjidhur çështjen me ndërmjetësim.

## II. Objekti i kontrollit dhe analiza ligjore

Inspektimi tematik filloi me fazën e parë, hartimin e kërkesave për informacion dhe akteve drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Nga ana e inspektorëve, në funksion të realizimit të inspektimit, janë administruar të dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ku është mundësuar marrja e informacionit dhe materialet e dërguar në mënyrë shkresore dhe elektronike me email<sup>1</sup>, nëpërmjet shkresës së dërguar nga kjo zyrë, me nr. 2085 prot., datë 02.04.2024.

Të dhënat e marra nga gjykatat sa më sipër lidhen me informacionin dhe dokumentacionin shkresor të mëposhtëm gjatë periudhës kohore objekt të inspektimit 01.10.2023-31.12.2023:

- Të dhënat sipas formularëve të përgatitur nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit.
- Të dhënat mbi numrin e rasteve që kanë pranuar zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim;
- Kopje të njësuara të shkresave që dokumentojnë se gjyqtarët kanë informuar palët mbi zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim.
- Plotësimi i tabelave, nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, sipas modelit të vendosur në dispozicion nga ILD.
- Çdo informacion tjetër, i cili do të dalë i nevojshëm gjatë kryerjes së inspektimit.

Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analiza e të dhënave të marra nga zyrat e gjykatave, është përqendruar në drejtim të (i) numri i çështjeve civile themeli të përfunduara për periudhën kohore 01.10.2023- 31.12.2023, (ii) numri i çështjeve në të cilat gjykata ka informuar palët në lidhje me mundësinë e zgjidhjes së konfliktit me ndërmjetësim, (iii) numri i çështjeve në të cilat palët kanë pranuar për ta zgjidhur çështjen me ndërmjetësim.

Trajtimi i këtyre të dhënave, është bazuar në analizën dhe interpretimin e dispozitave përkatëse të Kushtetutës, Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, si dhe të ligjit nr. 10385/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar.

<sup>1</sup> Regjistruar në ILD me nr. 500/3 prot., datë 18.03.2024, e-mail i kancelares znj. Viola Kondo datë 18.03.2024, e-mail i kancelares znj. Viola Kondo datë 02.04.2024.

Metodologjia e ndjekur për përpunimin e të dhënave me qëllim arritjen e rezultateve të këtij inspektimi, është realizuar nëpërmjet kontrollit të çështjeve civile për të cilat gjykata është shprehur me vendim përfundimtar, pasi bazuar në nenin 158/ç, pikat 1 dhe 2 të KPC, parashikohet se: *“1. Gjyqtari, gjatë veprimeve përgatitore, bën të gjitha përpjekjet për të zgjidhur mosmarrëveshjen me pajtim, kur e lejon natyra e çështjes. Për këtë qëllim, kur është rasti, urdhëron edhe paraqitjen e vetë palëve. 2. Në çdo fazë të gjykimit, gjykata vë në dijeni palët lidhur me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim dhe nëse ato pranojnë e kalon çështjen për ndërmjetësim...”*. Përzgjedhja e kësaj metodologjie është bërë me qëllim garantimin e rezultateve relevante të inspektimit duke mbajtur në vëmendje edhe moscenimin e pavarësisë së gjyqtarit në ushtrimin e funksioneve dhe veprimtarisë së tij, nga kontrollet e ILD-së për këtë objekt.

Inspektimi tematik paraqet rëndësi sa i përket, forcimit të transparencës, efikasitetit të gjykatës për të rritur përdorimin e procedurës së ndërmjetësimit në përputhje me standardet kushtetuese, ligjore dhe evropiane, rritjes së standardeve në veprimtarinë e gjykatave nëpërmjet misionit monitorues e mekanizmave të inspektimit, të cilat synojnë që sistemi gjyqësor të respektojë Kushtetutën, ligjet, të jetë i aftë për të realizuar dhe mbrojtur dinjitetin, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritimit evropian të Republikës së Shqipërisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në respektim të Kushtetutës dhe kuadrit ligjor aktual vlerëson të theksojë pavarësinë e magjistratëve në ushtrim të funksioneve të tyre të lidhur këtë edhe me respektimin e të drejtave dhe detyrimeve që ata kanë në aspektin e zbatimit të ligjit. Porë në këtë këndvështrim Inspektori i Lartë i Drejtësisë, udhëhiqet dhe nga parimi i ligjshmërisë, në kuptimin që si organ kompetent ka detyrimin të hetojë, nëse ka dyshime të arsyeshme se magjistrati ka kryer një shkelje disiplinore sa i përket edhe mospërbushjes nga ana e tij e detyrimeve të përcaktuara në ligj.

Thelbi i institutit të inspektimit dhe mekanizmave të kontrollit është në mbrojtjen e interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë. Kjo arrihet nëpërmjet vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit, këshillimit të subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore, urdhërimit të korrigjimit të shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin prej tyre, marrjes së masave të tjera administrative për shmangien e rreziqeve që mund t'u shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në ligj.



Në përgjigje të kërkesës së ILD-së për të dhëna në kuadër të inspektimit tematik Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës<sup>2</sup> vendosi në dispozicion dokumentacionin me të dhënat sipas formularëve të përgatitur nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit shoqëruar me procesverbalet e seancave në të cilat gjyqtari ka informuar palët mbi zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim; tabelën me të dhënat statistikore për numrin e përgjithshëm të çështjeve civile të përfunduara për periudhën e inspektimit 01.10.2023–31.12.2023 nga secili gjyqtar; tabela me të dhënat lidhur me numrin e çështjeve ku secili gjyqtar ka informuar palët për mundësinë e zgjidhjes së konfliktit me ndërmjetësim dhe tabela ku informacioni është i pasqyruar, sipas objektit të çështjes.

Në formularin *Dokument Për Informimin Dhe/Ose Referimin e Rastit në Ndërmjetësim*, i cili i vihet në dispozicion palëve në mosmarrëveshje, rezulton i pasqyruar plotësimi i të dhënave si vijon:

- Në lidhje me të dhënat e çështjes: Gjeneralitetet e palës paditëse (emri, mbiemri dhe kontakti); Gjeneralitetet e palës së paditur (emri, mbiemri dhe kontakti); Natyra e mosmarrëveshjes dhe objekti i saj; Konfirmimi i palëve për informimin mbi ndërmjetësimin; Vendi dhe data.
- Referuar nga: Gjykata dhe seksioni përkatës; Gjyqtari i çështjes.
- Marrësi i referimit: Dega përkatëse e DHKN; Adresa dhe Kontakti.

Gjithashtu në këtë formular si referencë pasqyrohet se: “Ky formular është hartuar me qëllim monitorimin e zbatimit të nenit 25 të Kodit të Procedurës Civile, në kuadër të projektit pilot me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në zbatim të treguesit 7, të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe planit të saj të veprimit 2021-2025”.

Procedura e ndërmjetësimit në procesin civil është e parashikuar në Kodin e Procedurës Civile, i cili me ndryshimet e fundit me ligjin nr. 38/2017, datë 30.03.2017 në nenin 25 përcakton se: “Është detyrë e gjykatës që të bëjë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje dhe/ose të njoftojë e të udhëzojë palët për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim”.

Kodi i Procedurës Civile në nenin 158/ç, pika 2 parashikon që “Në çdo fazë të gjykimit, gjykata vë në dijeni palët lidhur me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim dhe nëse ato pranojnë e kalon çështjen për ndërmjetësim” si dhe në nenin 297/dh përcakton “Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur njëra nga palët paraqet kërkesën për zgjidhje të çështjes me ndërmjetësim dhe gjykata e vlerëson të arsyeshme”.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. 2085 prot., datë 02.04.2024 regjistruar pranë Ild me nr. 500/7, datë 05.04.2024.

Pra, gjykata në përputhje me nenet 25, 158/ç dhe 297/dh të Kodit të Procedurës Civile e trajton procedurën e ndërmjetësimit si “një hallkë jashtëgjyqësore që mund të ezaurohet paraprakisht” nga palët për mundësinë e zgjidhjes së konflikteve në bazë negocimi me vullnetin e tyre të lirë. Në këtë mënyrë, Kodi i Procedurës Civile e forcon zbatimin e ligjit “Për ndërmjetësimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” duke ndjekur qëllimin e përbashkët të dy rregullimeve ligjore për parandalimin e zgjidhjeve gjyqësore të mosmarrëveshjeve dhe të zbusë pasojat sociale të tyre.

### III. Gjetjet e inspektimit

Në zbatim të detyrimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar dhe analiza e informacionit mbi të dhëna, të përpunuara më sipër nga kjo gjykatë, në kuadër të inspektimit të ndërmjetësimit rezultoi se:

1. Për periudhën e inspektuar 01.10.2023–31.12.2023, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, janë përfunduar duke shpallur vendime përfundimtare, gjithsej **548 çështje** civile themeli.
2. Në zhvillimin e gjykimit për këto çështje të përfunduara, vetëm në **62 çështje** është përmendur specifikisht nga ana e gjyqtarëve, mundësia për zgjidhjen e konfliktit nëpërmjet ndërmjetësimit.
3. Në terma statistikore, detyrimi i gjyqtarëve për të informuar palët për zgjidhjen e çështjes nëpërmjet ndërmjetësimit është realizuar në masën 11.3%, të çështjeve gjyqësore të përfunduara për periudhën e inspektimit.
4. Në **62 çështjet** në të cilat është realizuar informimi i palëve për ndërmjetësimin, vetëm në **3 raste** është pranuar nga palët në proces, zgjidhja e çështjes me ndërmjetësim, e përkthyer kjo në terma statistikore, vetëm 4.8% e çështjeve janë zgjidhur me ndërmjetësim.
5. Nga analizimi i të dhënave të vendosura në dispozicion nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, rezultoi gjithashtu se vetëm disa gjyqtarë e kanë aplikuar në mënyrë specifike këtë detyrim, përkatësisht:

Nr.	Emër Gjyqtari	Numëri përgjithshëm të përfunduarash per periudhen e inspektimit	Sa informime për ndërmjetësim	Sa kanë pranuar	% e informimeve
1	R.Bekteshi	30	1	0	3.333333333
2	Sh.Pitaku	92	20	0	21.73913043
3	S.Mara	49	5	1	10.20408163
4	B.Garxenaj	59	7	0	11.86440678
5	E.Shedula	33	3	0	9.090909091
6	Sh.Laçaj	33	11	2	33.33333333
7	P.Çera	5	1	0	20
8	O.Skrane	61	10	0	16.39344262
9	M.Koça	32	3	0	9.375
10	A.Buzo	43	1	0	2.325581395
11	N.Pogaçe (Tafa)	30	0	0	0
12	D.Goxhaj	7	0	0	0
13	K.Kuro	66	0	0	0
14	S.Xhani	8	0	0	0
	<b>Totali</b>	<b>548</b>	<b>62</b>	<b>3</b>	<b>11.31386861</b>

6. Në lidhje me llojin e objektit mbi të cilin është kryer informimi i palëve në proces, për mundësinë e zgjidhjes së çështjes me ndërmjetësim, nga analiza e të dhënave të vendosura në dispozicion nga gjykata sipas tabelës në vijim rezultoi:

Nr. Rendor	Objekti	Nr.	Përqindja
1	zgjidhje martese	36	58.06451613
2	njohje pronar	6	9.677419355
3	pavlefshmeri	4	6.451612903
4	begatim pa shkak	1	1.612903226
5	kthim shume	3	4.838709677
6	lirim dorezim	1	1.612903226
7	kundershim vendimi permbarimot	2	3.225806452
8	permbushje detyrimi kontraktor	1	1.612903226
9	lejim levizje femije	2	3.225806452
10	pjestim pasurie	4	6.451612903
11	pagim page	1	1.612903226
12	likujdim shoqerie	1	1.612903226
		<b>62</b>	<b>100</b>

#### IV. Konkluzion

Inspektimi u zhvillua dhe përfshiu veprimtarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe të dhënat e administruara për periudhën e inspektimit, mundësuan njohjen dhe krijimin e një tabloje të përgjithshme mbi informimin e palëve nga gjyqtarët rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjeve me ndërmjetësim.

Nga inspektimi i kryer rezultoi se për periudhën 01.10.2023 deri më 31.12.2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës janë shpallur vendime përfundimtare gjithsej për **548 çështje** civile themeli. Nga këto në **62 raste** ose 11.3% e totalit të çështjeve civile, është realizuar detyrimi i gjyqtarëve për të informuar palët për zgjidhjen e çështjes nëpërmjet ndërmjetësimit dhe vetëm në **3 raste** është pranuar nga palët zgjidhja e çështjes me ndërmjetësim përkthyer kjo në terma statistikore vetëm 4.8% e çështjeve.

#### V. Rekomandimet

##### 1. Për gjykatën subjekt të inspektimit:

- Raporti i inspektimit t'i njoftohet gjykatës së inspektuar në zbatim të parimit të transparencës së veprimtarisë inspektuese me qëllim njohjet me problematikat e konstatuara.

- Rekomandohet që të rritet numri i informimeve nga ana e gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim si detyrim ligjor si dhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Kontratës Sektoriale “BE për Reformën në Drejtësi”, miratuar me vendimin nr. 476, datë 10.07.2019, të Këshillit të Ministrave mbi “Miratimin në parim të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian”, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2018.
- Rekomandohet që gjyqtarët në zbatim të nenit 25 të K. Pr. Civile të bëjnë përpjekje në mënyrë të ndjeshme me një qasje proaktive, për njoftimin dhe udhëzimin e palëve për mundësinë e zgjidhjes së çështjes me ndërmjetësim, duke dhënë informacion të plotë mbi llojin e procesit dhe përfitimet procedurale, kohore dhe financiare të palëve dhe gjykatës.
- Rekomandohet që të hartohet një letër e të drejtave mbi ndërmjetësimin, e cila t’u vihet në dispozicion dhe t’u bëhet me dije palëve që në seancën përgatitore për njoftimin dhe udhëzimin e palëve për mundësinë e zgjidhjes së çështjes me ndërmjetësim.

## 2. Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

- Ndjekja në vazhdimësi e plotësimit të rekomandimeve të lëna për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 147/d, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 194, pika 4 dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

### PROPOZOJMË:

1. Përfundimin e inspektimit tematik të nisur me vendimin nr. 7, datë 15.02.2024, “Për kryerjen e inspektimit tematik të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me objekt “Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për çështjet civile të përfunduara për periudhën 01.10.2023-31.12.2023”, i ndryshuar, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Caktimin e periudhës nga data 15.06.2024 deri në datën 15.01.2025, si periudhë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

3. Të njoftohet Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për përfundimin e inspektimit tematik, duke i dërguar edhe një kopje të Raportit të Inspektimit.

### INSPEKTORËT

**Erjena Bashari**



**Periand Teta**

